

- 48 -

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETARE I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE

V E N D I M

Nr. 12 Date 05. 09 .2012

**“PER
MIRATIMIN E LEJES
PER PERDORIM TE REZERVES UJORE
PER PRODHIM HIDROENERGJIE.**

Bazuar ne ligjin nr. 8093 dt. 21.06.1996 “Per rezervat ujore”, neni 18 germa dh, dhe te vendimit nr. 87 dt. 16.01.2008 te K.M., “Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 27 dt. 19.01.2007 te K.M.”Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncesioneve”, te ndryshuar, ne Kreun XI, piken 9,”Shpallja e fituesit dhe negociimi i kontrates”,si dhe te V.K.M. nr. 708 dt. 21.05.2008, me propozim te A.U.B. Drin-Bune, Keshilli i Basenit Ujembledhes Drin-Bune :

V E N D O S I :

MIRATIMIN e Lejes per Perdorim te Rezerves Ujore, Perroi i Tucepit, Komuna Ostren,Qarku Diber, per “ Hydrocentralin Tucep “ shoqerise “Tucep” per prodhim hidroenergjie, nga kuotat e vepres te marrjes ne perroin e Tucepit + 936 m, deri ne godinen e centralit ne kuoten + 850, ku eshte ndertuar godina e centralit, e ndertuar kjo qe ne vitin 1968 dhe e privatizuar nga ky subjekt.

Prurja qe do perdore subjekti eshte $Q = 0.76 \text{ m}^3/\text{sek}$, ndersa prurje mesatare e perroit eshte $2.1 \text{ m}^3/\text{sek}$.

Shoqeria ka Kontrate Koncesionare me M.E.T.E. te forms “ROT” me Nr. 703 Rep, Nr. 295/1 Kol. Dt. 27.06.2012.

Leja e perdorimit te rezerves ujore per prodhim hidroenergjie jepet me kusht qe te mos kufizohet furnizimi me uje te pijshem dhe nevojave te bujqesise ne zone.

Ngarkohet A.U.B. Drin-Bune per zbatimin e ketij vendimi.

PER KESHILLIN E BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE

Sekretari

Muhamet MUÇA



Kryetare

Voltana ADEMI